



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 518/3 Prot.

Tiranë, më 23/06/2020

V E N D I M

Nr 12, datë 23.06.2020

“PËR

**DISA SHTESA, NË RREGULLOREN PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË NË UNIVERSITETIN
POLITEKNIK TË TIRANËS DHE NE RREGULLOREN E KOMISIONIT TE PROMOVIMIT TE
PERSONELIT AKADEMIK”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, pika 1, shkronja d, në mbledhjen e datës 23.06.2020, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Në Rregulloren për Fitimin e Titujve Akademikë në Universitetin Politeknik të Tiranës, të miratuar me Vendimin Nr. 25, datë 13.12.2019 të Senatit Akademik, në nenin 19, pas pikës 5, shtohen pikat 6, 7, 8 dhe 9 me përmbajtje si më poshtë:
 6. Kur kandidati nuk është personel akademik i UPT-së, ai plotëson dosjen në përputhje me komizën ligjore në fuqi dhe me rregulloren e fitimit të titujve akademikë në UPT.
 7. Dosja i paraqitet Rektorit të UPT- së në rugë institucionale, i cili ja përcjell atë KPPA.
 8. KPPA pasi shqyrton fushën akademike të kandidatit si edhe elementët përbërës të dosjes së tij në përputhje me rregulloren e fitimit të titujve akademikë në UPT, ja përcjell dosjen drejtuesit të njësisë kryesore të UPT – së, që mbulon fushën akademike në fjalë.
 9. Më pas procedura vijon në mënyrë të njëjtë si për kandidatët e UPT – së dhe departamenti i ngarkuar nga drejtuesi i njësisë kryesore respektive për vlerësimin e

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi “Nënë Tereza”, Nr.4, Tiranë,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al

dosjes, kryen vlerësimin e saj nga pikëpamja e kërkimit shkencor si edhe shqyrton dokumentacionin për anën didaktike nga pikëpamja e përmbushjes së kriterëve ligjorë.

2. Në Rregulloren e Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës, të miratuar me Vendimin Nr. 26, datë 13.12.2019 të Senatit Akademik, në nenin 10, pas pikës 11, shtohen pikat 12, 13, 14 dhe 15 me përmbajtje si më poshtë:
 12. Kur kandidati nuk është personel akademik i UPT-së, ai plotëson dosjen në përputhje me komizën ligjore në fuqi dhe me rregulloren e fitimit të titujve akademikë në UPT.
 13. Dosja i paraqitet Rektorit të UPT- së në rugë institucionale, i cili ja përcjell atë KPPA.
 14. KPPA pasi shqyrton fushën akademike të kandidatit si edhe elementët përbërës të dosjes së tij në përputhje me rregulloren e fitimit të titujve akademikë në UPT, ja përcjell dosjen drejtuesit të njësisë kryesore të UPT – së, që mbulon fushën akademike në fjalë.
 15. Më pas procedura vijon në mënyrë të njëjtë si për kandidatët e UPT – së dhe departamenti i ngarkuar nga drejtuesi i njësisë kryesore respektive për vlerësimin e dosjes, kryen vlerësimin e saj nga pikëpamja e kërkimit shkencor si edhe shqyrton dokumentacionin për anën didaktike nga pikëpamja e përmbushjes së kriterëve ligjorë.
3. Ngarkohet Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Andrea MALIQARI



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al